



# INSTRUKSIONE PARAPERGADITËSE

## Kosova Makers League (KML) Open Raundi 4

**Data e publikimit: 12.04.2019**

Pasi koha për sfidën e katër po ofrohet dhe çdo herë e më tepër sfidat po vështirësohen dhe periudha kohore për realizimin e saj po shkurtohet, ne ju sygjerojmë të avanconi më tepër njohuritë për programimin e robotit mBot.

Duke i pasur parasysh vështirësitë që mund të hasni gjatë programimit, ju udhëzojmë të praktikoni gjithë kohës lëvizjet e robotit duke i kombinuar ato me sensorë të ndryshëm. Sensorët që mund të ushtroni gjatë kësaj kohe janë **Ultrasonic Sensor**, **Line Follower** si dhe **Light Sensor**.

Në sfidën e raundit të katërt parashihet që të vendosni një tunel ku roboti do të kalojë përmes tij. Këtu kemi vendosur që ju të vlersoheni edhe për kreativitetin në punën e dorës. Ju mund të përdorni materiale nga më të ndryshmet për të zbukuruar tunelin; si letra ngjitëse, ngjyra, plastelin, oriz etj.

Njëherit roboti juaj mund të maskohet që të luaj një rol të caktuar dhe të kryej një funksion të veçant për të tjerët. Në këtë pjesë do të keni instruksione më të detajuara në dokumentin final te raundit të katërt.

Keni vëmendjen, për t'a përgaditur sfidën e raundit të katërt ju do të keni **4 ditë** kohë prej kohës që sfida është publikuar. Sfida do të publikohet me **22 Prill** dhe videot do të pranohen në grupi e Kosova Makers League në Vimeo deri më datën **25 Prill**.